



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada - Gillogjani kryesuese, Ferki Xhaferi, anëtar, Kymete Kicaj, anëtare, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Fidan Sadiku kandidat për anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për komunën e Gjilanit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Gjilan, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së, me Nr.1719-2021, i datës 30.06.2021, për shkak të mos emërimit për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në komunën e Gjilanit, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet e Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 06.07.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli Anr.1/2021 i datës 02.07.2021, i parashtruar nga Fidan Sadiku kandidat për anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në komunën e Gjilanit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Gjilan, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së, me Nr.1719-2021, i datës 30.06.2021, për shkak të mos emërimit për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për komunën e Gjilanit, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 02.03.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Fidan Sadiku kandidat për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Gjilan, në të cilin theksohet se përmes emaili nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tek Zyrtari Komunal i Zgjedhjeve ZLKKZ, është njoftuar gojarisht subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje se i propozuari Fidan Sadiku nuk është rekomanduar për anëtarë të KKZ-së, meqë në “arsyetimin”, e dhënë është thënë se i njëjti është dënuar me Aktgjykim të Plotëfuqishëm:P-1153/2019 të datës 22.03.2021, dhe se nuk ka plotësuar kriterin ligjor për t’u emëruar anëtar i KKZ-së në komunën e Gjilanit, theksohet ne apel. Më tutje parashtruesi i apelit thekson se SKQZ-ja në njoftimin e saj është bazuar në rregullën 18/2016 respektivisht nenin 5.1(1.4), duke mos marrë parasysh aktgjykimin në fjalë, dënimin e shqiptuar dhe pasojat juridike të dënimit, sipas së cilave pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba në të holla apo vërejtja gjyqësore, për me tepër vepra penale për të cilën jam dënuar nuk hyn në kapitullin VXIII të KPK-së, ashtu siç parashihet në nenin 5.2 (2.5) të Rregullës 18/2016, e cila do të mund të përbënte bazë për përjashtim apo mos rekomandim nga ana e SKQZ-së. Po ashtu parashtruesi i apelit thekson se në njoftimin zyrtar P.Nr.1153/2019 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan të datës 23.04.2021, interpreton se tek dënimet me gjobë apo me vërejte

gjyqësorë nuk krijohen pasoja juridike për personin të cilit i dedikohet (neni 93 i KPK-së) si dhe se është kryer rehabilitimi ligjor sipas nenit 96 të KPK-së dhe se i lartcekuri Fidan Sadiku është shlyer nga evidenca e personave të dënuar me rastin e pagesës së gjobës së caktuar.

Parashtruesi i apelit i ka bashkangjitur apelit Aktgjykimin e Plotëfuqishëm:P-1153/20219 të datës 22.03.2021, njoftimin zyrtar P.Nr.1153/2019 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan i datës 23.04.2021, njoftimin me shkrim përmes emaili nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 30.06.2021.

PZAP-i, me datë 03.07.2021, në kuptim të nenit 11.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, kërkoi nga parashtruesi i apelit që të plotësohet dhe përmirësohet apeli brenda afatit të përcaktuar, pasi që i njëjti përmban disa mangësi për tu proceduar më tutje.

Parashtruesi i apelit me datë 03.07.2021, ka paraqitur plotësimin e apelit në të cilin ka theksuar se, “Unë Fidan Sadiku jam i propozuar anëtar në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) nga Lëvizja Vetëvendosje në Gjiilan, dhe se me vendimin e KQZ-së Nr.1719/2021 të datës 30.06.2021, ka bërë emërimin e anëtarëve të KKZ-së, për Komunën e Gjiilanit, me njoftim të vendimit për refuzimin tim nuk jam pajisur në formë fizike e as elektronike, përpos një emaili njoftues nga ZLKKZ në Gjiilan, me të cilin do të udhëzoheshim në mjetin juridik”, prandaj kërkon nga PZAP që vendimin për refuzimin e emërimit tij ta revokoj në bazë të ankesës dhe dëshmimeve të cilat i ka dorëzuar përmes apelimit, duke ju bashkangjitur shtesën me të gjitha dokumentacionet dhe nga të cilat dëshmohet se nuk ka asnjë pengesë ligjore që ta përfaqësoj LVV-në në KKZ Gjiilan, theksohet në plotësim të apelit nga pala ankuese.

Parashtruesi i apelit në plotësim të apelit ka bashkangjitur kopjet e tri emailve, të datës 30.06.2021 dhe datës 01.07.2021.

PZAP-i me datën 02.07.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në apel.

KQZ, ka dërguar përgjigjen në apel më datën 03.07.2021, në të cilën theksohet se, KQZ brenda afatit të paraparë me Planin Operacional për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 17 tetorin 2021, ka pranuar nga subjektet politike të gjitha nominimet për anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) për 38 komunitat e Kosovës, bazuar në nenin 67 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 3,4 dhe 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Pas pranimit të nominimeve për anëtarë të KKZ-ve nga subjektet politike, Sekretariati i KQZ-së, ka shqyrtuar nominimet në bazë të kriterëve që përcaktohen në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Kreu i XI dhe Rregullën Zgjedhore Nr.18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve dhe kreun e XI të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, ku disa nominime janë refuzuar për arsye që nuk kanë plotësuar kriteret ligjore për tu emëruar anëtar i KKZ-së.

Nominimet nga subjektet politike janë verifikuar nga:

- Divizionin i Shërbimit Votues të KQZ-së, se a janë të gjitha nominimet nga komunitat përkatëse.

- Lista e pranuar nga PZAP-ja për personat të cilëve PZAP i'u ka ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje, dhe pas verifikimit të nominimeve, ka rezultuar se, nuk kemi pasur asnjë nominim të cilëve i'u ndalohe pjesëmarrja në zgjedhje.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), se a është ndonjë person në listën e nominimeve nga subjektet politike për anëtar të KKZ-ve, i dënuar, në tre (3) vitet e fundit për vepër penale, me vendim të formës së prerë të gjykatës, sipas nenit 5, paragrafi 1, nënpika 4, të Rregullës Zgjedhore 18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, ku thuhet: “Personi i nominuar për emërim për anëtar të KKZ-së, duhet të plotësoj kriterin ligjor që: “Të mos jetë i dënuar për vepër penale me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës, tre (3) vitet e fundit”.

Pas verifikimeve nga KGJK, të nominimeve për anëtar të KKZ-ve nga subjektet politike kanë rezultuar se shtatë (7) nominime (persona) nuk i plotësojnë kriterin ligjor për të qenë anëtar i KKZ-së, në mesin e tyre edhe personi i nominuar nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje” për anëtar të KKZ-së në komunën e Gjilanit z.Fidan Sadiku, i cili nga KQZ, nuk është rekomanduar për emërim në KQZ, për arsye se, pas verifikimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i njëjti rezultoi se, është i dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm: P-1153/2019 të datës 22.03.2021, prandaj i njëjti nuk ka plotësuar këtë kriter ligjor, për t'u emëruar anëtar i KKZ-së në komunën e Gjilanit.

SKQZ, në bazë të nenit 69 pika 3 ka njoftuar Kryesuesin e KKZ-së në Komunën e Gjilanit z. Ferid Shabani, që ta njoftoj, subjektin politik “Lëvizja Vetëvendosje” për arsyet e refuzimit të emërimit të personit të nominuar dhe brenda afatit ligjor, deri më datën 05.07.2021, të kërkoj nga ky subjekt politik që të dorëzoj në zyrën e KKZ-së, nominimin e ri për anëtar të KKZ-së për komunën e Gjilanit

Prandaj, mos emërimi i z. Fidan Sadiku për anëtar të KKZ-së, është i bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr.KO95/2020, të datës 06.01.2021, listën e verifikimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që i njëjti rezultoi se, është i dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm: P-1153/2019, të datës 22.03.2021, si dhe nenin 5, paragrafi 1, nënpika 4, të Rregullës Zgjedhore 18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me refuzimin për emërimin e tij për anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Gjilan ju është bërë e padrejtë pasi që të njëjti i është mohuar e drejta për të qenë anëtar i KKZ-së në Gjilan, Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 5 par.1 nën pika 1.4 të Rregullës Zgjedhore 18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, parasheh që: “Personi i nominuar për emërim për anëtar të KKZ-së, duhet të plotësoj kriterin ligjor që: “Të

mos jetë i dënuar për veprë penale me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës, tre (3) vitet e fundit”.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1719-2021, i datës 30.06.2021, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 5 par.1 nën pika 1.4 të Rregullës Zgjedhore 18/2016, për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, pasi që parashtruesi i apelit Fidan Sadiku kandidat për anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në komunën e Gjilanit, është shpallur fajtor për veprë penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm P-1153/2019, të formës së prerë të datës 22.03.2021.

Fakti se parashtruesi i apelit pretendon se dënimi i shqiptuar është shlyer nga evidenca e të dënuarve, për Panelin rrethanat e tilla nuk krijojnë mundësi për përshtatshmërinë e kandidatit për emërimin në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, nga se sipas Rregullës Zgjedhore 18/2016, për tu emëruar si anëtar i KKZ-së, duhet shikuar se kandidati a i plotëson kriteret ligjore të parapara nga neni 5 par.1 nën pika 1.4 të Rregullës Zgjedhore 18/2016.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe mbi këtë bazë i njëjti nuk i plotëson kriteret e sipërcituara për tu emëruar si anëtar i KKZ-se, dhe mbi këtë baze si dhe në pajtim me nenin 115.1, nenin 117.3 e lidhur më nenin 118.1, të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1/2021 më datën 06.07.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.